



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	20.04.2016
REFERENC-Ë:	AKK - DPKPP 03-03/4496/15
PËR/ZA/TO:	z. Artan Fejza , Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit në Ministrinë e Administratës Publike
CC:	z. Arton Berisha , Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Administratës Publike
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni , Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Furnizim me pajisje të TI - së "

I nderuari z. Fejza ,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nënpar. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nënpar. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nënpar. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " Furnizim me pajisje të TI - së " me numër prokurimi 202-16-020-121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Furnizim me pajisje të TI - së " me numër prokurimi 202-16-020-121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 05/1 -068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/1-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/1-237.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 30.11.2015, ka nxjerrë vendim me numër protokolli *AKK-03-3-1201/16* për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull "*Furnizim me pajisje të TI - së "* me numër të prokurimit: *202-16-020-121*, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Ministria e Administratës Publike - MAP.

Me datë 23.03.2016, Agjencia kundër Korrupsionit ka paraqitur njoftimin për pjesëmarrje në vëzhgim pranë Autoritetit Kontraktues të cilin e ka njoftuar se Agjencia do të merr pjesë në cilësinë e vëzhguesit në procesin rreth ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve. Agjencia pasi ka trajtuar dokumentet në dispozicion dhe ka marr pjesë në monitorimin rreth vlerësimit të tenderëve ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Autoriteti kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë të llojit furnizim me vlerë të mesme të kontratës të cilën e ka ndarë në dy lote (pjesë).

Për këtë aktivitet të prokurimit dosjen e tenderit e kanë tërhequr gjithsej 38 Operator ekonomik ndërsa ofertat për këtë kontratë i kanë dorëzuar 4 prej tyre. Në lot 1 kanë ofertuar 4 Operator ekonomik ndërsa në lot 2 kanë ofertuar 2 OE.

Komisioni për ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve, pas vlerësimit të ofertave ka konstatuar se nga katër ofertat e pranuar për këtë tender, tri prej tyre janë oferta të përgjegjshme në pajtim me të gjitha kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, ndërsa vetëm njëra prej ofertave është e pa përgjegjshme, pasi që nuk është në pajtim me të gjitha kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit. Për lot 1 komisioni vlerësues ka rekomanduar për kontratë Operatorin e renditur me nr.2 në procesverbalin e hapjes së tenderit, ndërsa për lot 2 ka rekomanduar për kontratë Operatorin e renditur me nr.3, të cilët sipas komisionit vlerësues kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët.

Agjencia kundër Korrupsionit ka vërejtur se në njoftimin e publikuar për këtë kontratë tek lot 2 pika II.7 tek vlera e parashikuar e kontratës, Autoriteti kontraktues ka paraparë vlerën 5000 €, ndërsa ofertat për këtë lot kanë ardhur mbi këtë vlerë më saktësisht OE i rekomanduar për lot 2 ka ofruar çmimin prej 5,528.20 €. Në bazë të nenit 62 paragrafi 1 thuhet se Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njëri nga arsytet më saktësisht në pikën 1.2 ka paraparë situatën kur " të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit i njëjti duhet të anulohet ". Agjencia pasi ka ekzaminuar dhe analizuar me kujdes specifikimet teknike për lot 2 ka vërejtur se Autoriteti kontraktues ka kërkuar të furnizohet me Tabled të prodhuesit *Apple modeli IPAD A8 me sistem të operimit iOS 9*. Agjencia pasi ka analizuar kërkesën e njësisë kërkuese dhe dosjen e këtij tenderi, konstaton se Autoriteti kontraktues ka përcaktuar prodhuesin e këtyre pajisjeve duke mos shtuar edhe fjalët "*ekuivalente ose e barasvlershme*"

Me përcaktimin e emrit të prodhuesit të këtyre mallrave, mund të favorizohen prodhuesit e caktuar dhe në të njëjtën kohë diskriminohen prodhuesit tjetër të këtyre pajisjeve. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë që produkti të jetë i kualitetit të lartë dhe mund t'i referohet një standardi vendor, European ose ndërkombëtar, por nuk lejohet asesi që mallrat të kërkohen nga ndonjë prodhues i caktuar.

Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, është si rregull i përgjithshëm i ndaluar. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdoret në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët "*ose e barasvlershme*".

Shqetësuese mbetet për AKK-në, kërkesa e Autoritetit kontraktues që të furnizohet me pajisje të tilla nga prodhuesi *Apple* kur kihet parasysh fakti se në treg produktet e këtij prodhuesi janë nga më të shtrenjtat dhe konsiderohen si luksoze.

Veprimet e Autoritetit kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi, nenin 28 Specifikimet teknike të Ligjit për prokurimin publik Nr.04/L-042 dhe nenin 18 pika 7 të udhëzuesit operativ të prokurimit publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet të lejohen në procedura të prokurimit, **andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e lot 2** dhe kërkon nga Autoriteti kontraktues që t'i shmang praktikatat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë kundër Korrupsionit për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !